


RS  $\frac{2}{A20}$

# BULETINI I SHKENCAVE GJEOLOGJIKE

VITI XI (XXVIII) I BOTIMIT



Tiranë


1  
1994

# **BULETINI I SHKENCAVE GJEOLOGJIKE**

**ORGAN I PERBASHKET I INSTITUTIT TE STUDIMEVE  
DHE TE PROJEKTIMEVE TE GJEOLOGJISE DHE  
I FAKULTETIT TE GJEOLOGJISE DHE TE MINIERAVE TE  
UNIVERSITETIT POLITEKNIK TE TIRANES**

**1**

**TIRANE, 1994**



## PERMBAJTJA E LENDES (CONTENTS)

### SIMPOZIUMI I PARE I GJEOFIZIKES NE SHQIPERI (FIRST SYMPOSIUM ON GEOPHYSICS IN ALBANIA)

|   |   |
|---|---|
| <i>R. Avxhia.</i>   | U zhvillua simpoziumi i Parë Kombëtar i Gjeofizikës<br>( <i>First National Symposium on Geophysics in Albania</i> )   |
| <i>A. Frashëri, D. Mezini, L. Lubonja, Ll. Langora.</i>                 | Kërkimet gjeofizike në Shqipëri dhe zhvillimi i tyre në të ardhmen.....faqe 5<br>( <i>Geophysical prospecting in Albania and its future development</i> )   |
| <i>L. Lubonja, A. Papa, P. Nishani, A. Hyseni, S. Bushati, V. Leci.</i> | Vendi i Albanideve në brezin Alpin nën dritën e të dhënave gjeofizike.....faqe 9<br>( <i>The position of Albanides in the Alpine-Mediterranean Orogenic belt based on geophysical data</i> )  |
| <i>S. Bushati, A. Kodra, Ll. Langora.</i>                               | Ndërtimi i hartave krahinore gravimetrike<br>- dhe magnetometrike dhe interpretimi i tyre në studimin<br>gjeologjik të Albanideve.....faqe 15<br>( <i>Compilation of the regional gravity and magnetic maps and their interpretation to the geological study of Albanides</i> ) |
| <i>E. Sulstarova.</i>   | Vlerësimi i rrezikut sismik në Shqipëri.....faqe 19<br>( <i>Seismic hazard assessment in Albania</i> )  |
| <i>H. J. Mauritsch, P. Alikaj, V. Melo.</i>                             | Studime paleomagnetike në Shqipëri.....faqe 20<br>( <i>Paleomagnetic investigations in Albania</i> )  |
| <i>Sh. Aliaj.</i>   | Disa veçori sismotektonike të Shqipërisë.....faqe 23<br>( <i>Some peculiarities on seismotectonics of Albania</i> )   |
| <i>R. Cassinis.</i>   | The Alpine structure: The geophysical answer to the geological questions.....faqe 25<br>( <i>Struktura Alpine: Përgjigje gjeofizike për problemet gjeologjike</i> )   |
| <i>L. Hoxha, S. Bushati, Sh. Demi, N. Lika, F. Vinçani.</i>             | Një model gjeologo-gjeofizik për ofiolitet e Mirditës Qendrore.....faqe 41<br>( <i>A Geological-Geophysical Model for the ophiolites of Central Mirdita</i> )   |
| <i>A. Kodra, K. Gjata, Ll. Langora, S. Bushati.</i>                     | Disa të dhëna gjeologo-gjeofizike për serpentinitet sinrifore preofiolitike të jurasikut të sipërm në Albanidet e Breadshme.....faqe 43<br>( <i>Preophiolitic syn rift serpentinites in Inner Albanides</i> )   |
| <i>B. Duka, S. Bushati.</i>   | Fusha magnetike normale e Tokës në Shqipëri dhe<br>variacioni i saj shekullor.....faqe 44<br>( <i>The normal magnetic field in Albania and its secular variation</i> )  |
| <i>A. Frashëri, V. Leci, A. Hyseni.</i>                                 | Disa të dhëna mbi ndërtimin gjeologjik të gropës neogjenike të Burrelit sipas sondimeve elektrike.....faqe 45<br>( <i>Burrel depression according to electrical sounding</i> )  |

- P. Leka, L. Hoxha, S. Nenaj, A. Daci, P. Kalina.* Veçoritë e kërkimeve elektrometrike të vendburimeve të bakrit që shtrihen nën shkëmbinjtë me përcjellshmëri të mirë.....faqe 47  
*(Peculiarities of the electrical prospecting of copper ore deposits overlaid with rocks of high conductivity )*
- P. Alikaj, E. Delaj.* Probleme të kërkimit të bakrit të pasur në formacionin vulkanogjeno-sedimentar me kompleksin gjeofizik racional.....faqe 50  
*(Problems in the search for rich copper ore in volcano-sedimentary series through the rational geophysical integration )*
- S. Kasapi, P. Leka, Th. Nathanaili, I. Jata, N. Kastrati.* Mbi zhurmat industriale dhe ndikimet e tyre në vrojtimet gjeolektrike.....faqe 51  
*(On the industrial noises and their influence on the Geophysical data )*
- N. Likaj, F. Duli.* Përdorimi i funksioneve hyrje-dalje me shuarje të shpejtë në metodën e katroreve më të vegjël për gjenerimin e filtrave lineare.....faqe 52  
*(The usage of rapidity decreasing input and output function in the least squares method to the generation of linear filters )*
- A. Dodona, A. Tashko.* Përcaktimi Gama spektrometrik i U, Ra, Th, K dhe disa zbatime gjeokimike.....faqe 55  
*(Gama-spectrometric determination of the U, Ra, Th, K and some geochemical applications )*
- A. Serjani, F. Dafa.* Zbatimi i metodave gjeofizike për kërkim zbulimin e fosforiteve.....faqe 57  
*(Application of Geophysical Methods in the search for phosphorites )*
- I. Islami.* Rreth saktësisë së përcaktimit të magnetizimit të kromiteve dhe shkëmbinje ultrabazikë nga kushtet e matjes me magnetometrin ASTATIK LM-24.....faqe 60  
*(About accuracy of determination of the chromite and ultrabasic magnetization, based on measurement condition with ASTATIC Magnetometer )*
- E. Xinxo.* Një algoritm për interpretim sasior të lakoreve të sondimeve elektrike të polarizimit të provokuar.....faqe 61  
*(An algorithm for quantitative interpretation of the JP electrical soundings curves )*
- R. Avxhiu, A. Zajmi.* Rreth gjendjes së sotme të zhvillimit të metodave gjeofizike në kërkimin e xehorëve të bakrit në vendin tonë dhe disa probleme që shtrohen për zgjidhje.....faqe 62  
*(About the present state of the development of the geophysical methods in search for Copper ores in our country and some problems to be solved )*
- P. Alikaj.* Studim mbi aspektet fizike të dukurisë së polarizimit të provokuar spektral.....faqe 64

*(A study on the physical aspects of the spectral induced polarization phenomenon )*

*U. Langora, Xh. Sharra, F. Duli, Ll. Prenga, P. Kërçanaj, A. Rrenja, A. Lulo.*

Aritje në përdorimin e kompleksit të metodave gjeofizike për kërkimin e mineralizimit të kromit dhe problematika për të ardhmen.....*faqe 65*  
*(Achievements on the application of the integrated geophysical methods for chrome prospecting and future problematics )*

*N. Krustev, K. Pavlov, St. Janev. Vlerësimi i thellësisë në rastin me*

*relief is komplikuar.....*faqe 67**  
*(Deep geoelectrical survey in complicated relief situation )*

*U. Langora, K. Naska, Dh. Gjevreku, Y. Bektashi. Studimet gjeofizike*

*nëntokësore një nga rrugët përmjet e efektivitetit të zbulimit të vendburimeve të bakrit dhe të kromit.....*faqe 68**  
*(The underground geophysical studies as a direction to increase the effectiveness of copper and chrome deposits exploration )*

*S. Dogjani, O. Lika. Problematika radiometrike në kërkimin*

*e minraleve të dobishme.....*faqe 69**  
*(Radiometric problematics in the search for ore minerals )*

*H. Mauritsch, B. Holub, U. langora, Dh. Gjevreku, S. Kasapi.*

*Studim petrofizik i shkëmbinjve ultrabazik të Shqipërisë.....*faqe 71**  
*(A petrophysical study of ultrabasic rocks of Albania )*

*N. Maska. Pajisje gjeofizike në shërbim të studimeve hidrogjeologjike.....*faqe 73**  
*(Geophysical equipments for hydrogeological investigations )*

*Y. Bektashi, S. Muçko, V. Murati, A. Jarko. Ndihamë e metodave gjeofizike*

*të pusit për vlerësimin cilësor dhe sasior të shpresave të qymyrit dhe në përcaktimin e rrjetave optimale të zbulimit.....*faqe 75**  
*(The contribution of the Down-hole geophysical methods in the qualitative and quantitative evaluation of the coal beds and in the determination of the optimal exploration grid )*

*S. Koçiraj. Vend i roli i metodave gjeofizike për qëllime të*

*mikrozonimit sismik.....*faqe 77**  
*(The place and the role of geophysical investigations for seismic microzoning purposes )*


*L. Kapllani. Zbatime të gjeofizikës inxhinjerike në ndihmë të projektimit*

*dhe studimeve gjeologo-inxhinjerike.....*faqe 80**  
*(Application of Engineering geophysics in aid of projections and studies of engineering geology )*

*N. Maska, P. Haxhiu, G. Kallfa. Studim kompleks gjeofiziko - hidrokimik*

*i burimeve karstike të Fushës së Bajzës në përethin e Shkodrës.....*faqe 81**  
*(Complex geophysical-hydrochemical study of karstic springs to the Bajza Plain of Shkodra district )*

- P. Lazo, A. Cullaj.* Analiza kimike e lantanideve në mostra shkëmbore me fotometër të emisionit atomik.....faqe 83  
*(Chemical analyses of Lanthanides in rocks by atomic emission photometry )*
- N. I. Manderson.* *Cano Limon oil field, Columbia, a geophysical case history*.....faqe 86  
*(Një rast historik gjeofizik-fusha e naftës Kano-Limon në Kolumbi)*
- Ph. Julien, S. Kaçulini.* *2D Prestack depth migration*.....faqe 88  
*(Migrimi i thellësisë Prestak-2D )*
- A. Bitri, D. Rappin, J. M. Marthelot.* Analiza e amplitudave, zgjedhja e rregjistrimeve dhe migrimi para mbledhës i të dhënave të reflektiveve të thella sismike.....faqe 94  
*(Amplitude analyses, record selection and prestack migration of deep reflection seismic data )*
- F. Fezga, B. Fritsch.* Analiza e trasesë sismike komplekse dhe interpretimi stratigrafik - Shëmbull i basenit të Raggatt-it (Platoja Kerguelen).....faqe 97  
*(Analyses de la trace sismique complexe et interpretation stratigraphique-Example du bassin de Raggatt (Plateau de Kerguelen.)*
- I. Dymant, M. Bano.* Complementary deep seismic, gravity and subsidence study in sedimentary basin environment: The Celtic Sea Basins.....faqe 100  
*(Studimet sismike komplete të thellësisë së gravitetit dhe të zhytjes në ambientin e pellgut sedimentar: Pelljet detare të Çeltikut)*



## U ZHVILLUA SIMPOZIUMI I PARE KOMBETAR I GJEOFIZIKES

Simpoziumi i parë Kombëtar i Gjeofizikës i zhvilloi punimet nga data 10 deri 11 Maj 1991 në sallat e Muzeumit Kombëtar të Historisë në Tiranë.

Ai u organizua nga Seksioni i Gjeofizikës i Shoqatës së Gjeologëve të Shqipërisë.

Nëntëdhjetë e tre specialistë dhe shkencëtarë të institucioneve shkencore dhe të ndërmarrjeve gjeofizike të vendit paraqiten 45 kumtesa. Njëmbëdhjetë kumtesa u paraqiten nga 13 shkencëtarë të huaj nga Austria, Bullgaria, Franca, Italia dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, disa nga këto kumtesa ishin përgatitur së bashku edhe me specialistët shqiptarë.

Në seancën plenare u dëgjua referati: "Kërkimet gjeofizike në Shqipëri dhe zhvillimi i tyre në të ardhmen". Pas kësaj, Simpoziumi i zhvilloi punimet në katër seksione: Gjeofizika krahinore (10 kumtesa); Gjeofizika për kërkimet e naftës dhe të gazit me nënseksionin e sizmikës (13 kumtesa) dhe të gjeofizikës së puseve (6 kumtesa); Gjeofizika e mineraleve të ngurtë (20 kumtesa) dhe në atë të Sizmologjisë, Gjeologjisë Inxhinierike dhe Kërkimeve Hidrogeologjike (7 kumtesa).

Përbledhjet e kumtesave në shqip dhe në gjuhën angleze botohen në Buletinin e Shkencave Gjeologjike dhe në Buletinin e Naftës e të Gazit, sipas fushës që i përkasin.

Për organizimin e simpoziumit punoi komisioni kryesor i organizimit, redaksia e përgjithshme ([Dr. Ligor Lubonja,] Dr. Lambi Langore, Prof. Dr. Eduard Sulstarova, Dr. Daver Çano, Dr. Halim Dariu dhe inxh. Spartak Nasto); grupi i redaktimit për seksionin e gjeofizikës së naftës (Dr. Pertef Nishani, inxh. Vladimir Veizaj) dhe për seksionin e gjeofizikës së mineraleve të ngurta (Dr. Radium Avxhiu, Dr. Fatmir Duli. Dr. Përparim Alikaj), si dhe komisioni teknik (Dr. Salvator Bushati, inxh. Burhan Çanga, Gazmend Sina, teknik gjeolog Ramazan Kurti). Komisioni organizues i simpoziumit përbëhej nga: Prof. Dr. Alfred Frashëri - Kryetar; Dr. Afat Serjani - Sekretar; Dr. Alaudin Kodra, Dr. Aleko Stamata, Dr. Fatmir Duli dhe Dr. Përparim Alikaj-anëtarë. Përgatitja e materialeve të simpoziumit për botim u bë nga A. Frashëri, R. Avxhiu, P. Alikaj dhe sekretari i redaksisë A. Serjani.

Radium AVXHIA

# KERKIMET GJEOFIZIKE NE SHQIPERI DHE ZHVILLIMI I TYRE NE TE ARDHMEN

**Alfred Frashëri**

**Drini Mazini**

**Ligor Lubonja**

**Llambi Langora**

**Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave**

**Ministria e Bërimeve Minerare dhe Energjítikës**

**Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave**

**Ndërmarrja Gjeofizike, Tiranë**

Shërbimi gjeofizik shqiptar, i krijuar dyzet vjet përpara, vjen sot në Simpoziumin Kombëtar të parë me arritje dhe me program të qartë pune për të ardhmen.

Shqipëria është vend me industri minerare të zhvilluar dhe gjeofizika përparoi si domosdoshmëri për të realizuar kërkimet gjeofizike me anën e metodave komplekse bashkëkohore. E nisëm punën nga fillimi, pa patur asnjë traditë nga e kaluara. Tipar karakteristik i gjeofizikës në vendin tonë është se ajo nga një pesëvjeçar në tjetrin, gjithnjë e më mirë, u zhvillua nga punonjësit e saj dhe nga specialistët e tjerë të gjeologjisë. Në përputhje me detyrat e shtruarar për zgjidhje dhe në përshtatje nie gjeologjinë e Albanideve, të cilat janë një brez i rrudhosur malor. Sot në vendin tonë ushtrojnë veprimtarinë tre ndërmarrje dhe dhjetë ekspedita gjeofizike të specializuara, të cilat e bashkërendojnë punën me institucionet dhe me ndërmarrjet gjeologjike të vendit për kërkimin e vendburimeve të naftës e gazit, bakrit, kromit, të polimetaleve, të boksideve, të shkrifërimeve, të qymyrit, të fosforiteve, të asbestit, të ujrale nëntokësorë, si dhe për studime gjéologo-inxhinjerike. Ato kryejnë edhe studime gjeofizike regionale. Zhvillohen studime sizmologjike komplekse nga Qendra e Sizmologjisë e Akademie e Shkencave. Specialistët e lartë gjeofizikë përgatiten në degën e gjeofizikës në Fakultetin e Gjeologjisë dhe Minierave të Universitetit Politeknik të Tiranës, ku bëhet edhe kualifikimi pasuniversitar i tyre.

Drejtum i rëndësishëm i zbatimit të gjeofizikës është kërkimi i vendburimeve të naftës e të gazit. Sizmika e valëve të reflektuara, me sisteme vrojtimi homogjen me mbulim shumëfish, është metoda kryesore midis metodave gjeofizike që përdoret për këtë qëllim. Ajo zë 92 përqind të vëllimit të studimeve gjeofizike për kërkimin e naftës e të gazit. Krahas saj, përdoret gravimetria dhe për ndonjë detyrë të veçantë edhe elektrometria. Për kërkimin e shtratimeve të gazit përdoret stratigrafia sizmike; veçanërisht, studiohen atributet e sinjalit sizmik. Studimi gjeofizik i puseve të thella të naftës e të gazit realizohet me anën e metodave të ndryshme të karotazhit elektrik, radioaktiv dhe akustik. Gjeofizika e naftës dhe e gazit ka dhënë ndihmesë për zbulimin e shumë vendburimeve të naftës dhe të gazit në vendin tonë, si Marinza e Kallëm - Verria, Cakrani, Arrëza, Amonica, Finiqi e Delvina, Karbunara, Divjaka

e Frakulla, Polevca, Ballaj dhe Durrësi, Panajaja etj.

Në të ardhmen, gjeofizika do të rritë cilësinë dhe sigurinë e interpretimeve me anën e përsosjes së teknologjisë së vrojtimeve dhe të përpunimit të informacionit sizmik, të karotazheve dhe të metodave të tjera. Eshtë në rend të ditës konsolidimi i arritjeve të stratigrafisë sizmike për kërkimin e gazit, zhvillimi i mëtejshëm i saj, zbatimi edhe për kërkimin e strukturave të gëlqerorëve. Kërkimi dhe zbulimi i vendburimeve të mineraleve të dobishme të ngurta eshtë një drejtim tjetër i zbatimit të gjeofizikës tek ne. Midis tyre vendin kryesor e zënë vendburimet e bakrit, për kërkimin e të cilëve përdoret metoda e polarizimit të provokuar dhe kohët e fundit edhe metoda e polarizimit të provokuar spektral, profilet dhe sondimet e rezistencës së dukshme, metoda TURAM, ajo e fushës elektrike natyrore dhe trupit të ngarkuar, më pak gravimetria dhe magnetometria. Kanë filluar studimet gjeofizike të puseve të shpimeve dhe të vrojtimeve nëntokësore për kërkimin rrëth punimeve minerare. Ndihmesa e gjeofizikës eshtë e ndjeshme në kërkim - zbulimin e dhjetra vendburimeve duke nisur me Gjegjanin, Tuçin, Kaçinarin e deri tek Qafbari, Palaj, Laku i Rroshit, Paluca, Perlati, Rehova etj. Në të ardhmen do të marrë zhvillimin e duhur kërkimi në thellësi të mëdha 600-800 m, do të deshifrohen anomalitë e përbëra, ato të dobëta dhe do të përpunohet teknologjia për të kryer vrojtëne pranë minierave, në kushtet e ekzistencës së zhurmave elektike industriale.

Nga viti në vit, duke punuar në fusha xehore, me gjeologji të kompjukuar, eshtë zgjeruar zbatimi i gjeofizikës për kërkimin e kromit, me anën e gravimetrisë, magnetometrisë, të polarizimit të provokuar, si dhe të magnetometrisë vektoriale dhe të gama-gama karotazhit në pusht e shpimeve. Me këtë eshtë ndjerë ndihmesa e gjeofizikës në kërkimin e vendburimeve të reja si ai i Tërnovës, Jugu i Batrës etj. Në këtë drejtim do të forcohet puna studimore dhe interpretuese për veçimin e anomaliave të shkaktuara nga trupat e kromit, mbi bazën e përsosjes së mëtejshme të kompleksit dhe të zgjerimit e thellimit të studimeve petrofizike.

Për të dy këta minerale, për atë të bakrit e të kromit, do të zërë vendin e duhur studimi gjeofizik i të gjitha puseve të shpimeve dëgjeofizika nëntokësore, me synim që të zgjelohet sasia e kampionit të nxjerrë në procesin e shpimit, të rrallohet rrjeti i punimeve minerare dhe shpimeve në fazën e parë të kërkimit, si dhe për shtimin e rezervave të mineraleve të dobishme rrëth punimeve minerare, midis të cilave edhe ato që ndodhen në thellësi të mëdha.

Në të ardhmen do të rritet më tej frytshmëria e kërkimeve dhe e studimeve gjeofizike të puseve për mineralet e tjera, si dhe do të zgjerohet sfera e përdorimit të gjeofizikës për kërkimin e mineraleve të reja. Do të zënë vendin e vet edhe studimet gjeofizike krahinore.

Veçanërisht ato sizmike, në zonën Mirdita. Po punohet për kompletimin e mëtejshëm të gjeofizikës inxhinjerike dhe asaj për kërkimet hidrogjeologjike. Përparimet e sizmologjisë, krasas studimeve mbi sizmicitetin e Albanideve, do të prekin edhe sferën e mikrozonimit sizmik dhe të inxhinjerisë së temeteve. Zgjidhja e detyrave teknike në miniera, si dhe studimi i presioneve minerare do të jetë një drejtim i ri, i rëndësishëm, i zhvillimit të gjeofizikës, veçanërisht tani që ndërtojmë dhe shfrytëzojmë miniera me kapacitete prodhuese të mëdha dhe në thellësi qindra metra.

Puna e lavdërueshme për matematizimin e përpunimit dhe interpretimit të informacionit gjeofizik, e cila filloj këtu e njëzet vjet më parë, me përdorimin e të parëve ordinatore në vendin tonë, do të ngrihet në nivele cilësore më të larta, me anën e hartimit të paketave të programeve të reja, që mbështeten në algoritme bashkëkohore. Në të ardhmen, duke u mbështetur fuqimisht në bazë të industriale dhe laboratorike të vendit tonë, punonjësit e

gjeofizikës dhe të uzinave të vendit, do të çojnë më përparrë ndërtimin e aparaturave gjeofizike, veçanërisht atyre me përdorim masiv.

Punonjësit e gjeofizikës, me devotshmërinë e tyre, me dinjitet dhe përvojën e fituar në këtë dyzet vjet, si edhe arritjet e gjeofizikës deri tani, përbëjnë bazën për të ecur përparrë, për ta bërë gjeofizikën në vendin tonë të aftë të zgjidhë në kohë dhe me cilësi të gjitha detyrat që i kanë vënë kërkimet gjeofizike sot dhe në perspektivë.

## GEOPHYSICAL PROSPECTING IN ALBANIA AND ITS FUTURE DEVELOPMENT

The Albanian Geophysical Survey created forty years ago, comes in this First National Symposium with achievements and a clear working program for the future.

Albania is a country with a developed mining industry where the geophysical survey has advanced continuously to support the Geological prospecting based on integrated contemporary methods. We started our work from the scratch with no heritage from the past. In conformity with the tasks to be solved and the geology of Albanides as an Alpine belt, our geophysics has broadened its scope and developed from year to year. At present there are three enterprises and ten geophysical expeditions in our country which coordinate their activity with geological institutions and enterprises in the search for oil and gas, copper, chrome, polymetals, bauxites, placers, coal, phosphorites, asbestos, groundwaters and engineering geology studies. They undertake regional geophysical surveys, too. Integrated seismological investigations are carried out by the Seismological Center of the Academy of Sciences. Higher school geophysical specialists graduate and postgraduate in the geophysics branch in the Faculty of Geology and Mining at the University of Tirana.

An important direction of the applied geophysics is the exploration for oil and gas deposits. The seismic reflection method with homogeneous survey systems of multiple coverage is the main geophysical method used for this purpose. It covers 92 per cent of the total of geophysical surveys for oil and gas. Besides, the gravity method is used, too and sometimes, for particular problems, the electrical prospecting are also made use of. In the search for relatively shallow gas deposits, seismic stratigraphy and especially the study of seismic signals attribute are used.

Borehole geophysics on deep oil and gas wells are carried out with the aid of different measurements of electrical, acoustic and nuclear well logging. The oil and gas geophysics has greatly contributed in the search for many oil and gas deposits in our country. In the future it will better the quality and certainty of interpretations through the improvement of measurement technology and data processing of seismic information, well-logging and other methods. The consolidation of seismic stratigraphy achievements for gas exploration, its further development and application in the search for limestone structures are on the agenda.

The search and discovery of solid mineral deposits is another direction of application of the geophysics in our country. Among them, the copper exploration plays the major role for geophysical methods, like Induced Polarization (IP), Spectral IP (recently), Resistivity, Self-Potential, Turam (EM), misse a la masse and less gravity and magnetic. The geophysical

investigations around the boreholes and mine works in the search for copper sulphide have started. The contribution of geophysics is important in the exploration of tens of copper sulphide deposits like those in Gjegjani, Tuçi, Kaçinari, Qaf-Bari, Palaj-Karrië, Laku i Roshit, Paluca, Perlati, Rehova, etc. The duties for the future are: further development of the deep exploration at the depths 600-800 m, resolutions of compound and weak anomalies and the ways to carry out measurements around the mines, in the conditions of electrical noises will be elaborated.

Year in year out, working in complicated geology, the application of geophysics in the search for chrome has been widespread. Methods like gravity, magnetic, induced polarization, while in boreholes the three component magnetic and gamma-gamma logging have been used. Through this variety of methods the contribution of geophysics in the search for new ore deposits like Ternova, South of Batra etc, or to enlarge the known ones like Shkalla, Pojska etc., has been evident. In this direction of anomalies causes by chrome ores through the further perfection of the exploration and extension as well deepening of the petrophysical studies.

For both these minerals, copper and chrome, the underground geophysical investigations of boeholes and mine works, through the logging and spatial measurements around them, will play a more important role aiming to reduce the drilling core samples, to rarefy the mine works and borehole grid in the first stage of exploration, to increase the mineral reserves around the mine works, among which those occurring at great depths.

In the future a further augmentation of the effectiveness of well-logging investigations for other minerals and extension of geophysical studies in the search for new minerals will incur. The regional geophysical studies, especially the seismic one, in Mirdita zone, will better play their own role. The further completion and consolidation of the geophysical groups in engineering geology and hydrogeological studies in being carried out. The advancements of seismology, parallel with the study of the seismicity of Albanides will enter into the scope of seismic microzoning and seismic engineering. The solution of technical duties in mines, as well the study of the mining pressure field, will be a new important direction of the geophysics development, especially at present when, in our country, big capacity mines, at the depth of some hundred meters are being constructed and exploited.

The good work for the mathematization of the data processing and interpreting of the geophysical information, with started twenty years ago, will be raised to higher quantitative levels through the compiling of new packets of programs based on contemporary algorithms.

In the future, our specialists based on the industrial and laboratory basis of the country will advance the construction of geophysical instrumentation, especially those of massive usage like underground geophysical instruments in order to widespread their application in mineral exploration.

Our geophysicists, with their devotion knowledge and experience gained these forty years as well the present achievements of the geophysics, constitute the basis to go ahead, to make our geophysics capable to solve all the duties charged by Geological Survey at the proper time and with a great quality.

## VENDI I ALBANIDEVE NE BREZIN ALPIN NEN DRITEN E TE DHENAVE GJEOFIZIKE

**Ligor Lubonja**

Asti Papa  
Pertef Nishani  
Adem Hyseni  
Salvator Bushati  
Vasillaq Leci

Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave  
Akademia e Shkencave  
Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave  
Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave  
Ndërmarrja Gjeofizike, Tiranë  
Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave

Albanidet, ose bashkësia e strukturave gjeologjike që përbëjnë territorin e Shqipërisë, janë një nyje e rëndësishme e brezit orogenik alpin mesdhetar.

Ato e kanë filluar evolucionin gjeologjik qysh në trias mbi një nënshtat hercian dhe janë formuar nga orogjeneza alpine. Etapat kryesore orogenike kanë qenë ato të fundit të jurasikut - fillimit të kretakut (paleotektonike), fundit të kretakut - eocenit (tektonike), oligocenit - miocenit (tarditektonike) dhe pliocen - kuaternarit (neotektonike). Etapa paleotektonike që shkaktoi zëniend vend të ofioliteve, si ashkla të kores oqeanike, ka prekur vetëm zonat e rendshme të Albanideve, duke i veçuar ato nga zonat e jashtme, të cilat janë pjesë përbërëse e buzinës kontinentale të Adrias ose të pllakës së Adriatikut dhe janë prekur vetëm nga etapat e mëvonshme tektonike, tarditektonike dhe neotektonike.


Formimi i fllshit, bashkë me fazat orogenike, mërgon në hapësirë e në kohë nga L (Albanidet e rendshme) drejt P (ALbanidet e jashtme).

Strukturat e Albanideve, me stil tektonik tipik alpin, zakonisht kanë drejtim JJL - VVP, janë asimetrike, me anim tektonik perëndimor, herë herë të shtrira e të përbysura, me shkëputje e zhvendosje të shumta, zakonisht në krahët perëndimorë, e që kalojnë në sharriazhime dhe në mbulesa tektonike të një zone mbi një tjetër, të cilat kanë sjellë aloktoninë e plotë të Albanideve të rendshme.

Të zhvilluara janë edhe dukuritë e tektonikës kripore, me futje diapiresh.

Në Albanidet shquhen edhe thyerje të thella gjatësore e tërthore, më e njohura nga të cilat është thyerja e tërthortë Shodër - Pejë, që ndan Albanidet vericre (të cilat vazhdojnë në Helenidet në Greqi). Si trevë e orogjenezës alpine, Albanidet kanë sizmicitet të lartë. Interpretimi i tipareve strukturore të Albanideve ka qënë bazuar në të dhënrat e gjeologjisë. Vitet e fundit argumentave gjeologjike u janë shtuar edhe të dhënrat gjeofizike, veçanërisht gravimetrike, magnetometrike e sismologjike, që ndihmojnë sidomos për njohjen e strukturës së thellë të Albanideve.

Në tablonë e përhapjes së fushës së forcës së rëndesës dallohet një brez anomal i



**Fig. 1. Harta kompleksë tektonike dhe aksete anomalisë magjë të forcës së rezistencës në Albanidet dhe në shelfin detar të Adriatikut (të dhënat gravimetrike të detit Adriatik sipas vitit 1980).** 1. Ultësira pranë adriatike; 2. Zona Jonike; 3. Zona Kruja; 4. Zona Krasta Cukali; 5. Zona Sazani; 6. Zona Mirdita; 7. Zona Korabi; 8. Zona Gashi; 9. Zona e Alpeve Shqiptare; 10. Nënzonja e Vermoshit; 11. Aksete Anomalive gravimetrikene negative a, pozitive b; 12. Izovlerat e fushës së rendesësni det; 13. Thellësia e pozitive a, negative b, të kores së tokës; 14. Kufi i UPA me mospatjum këndor; 15. Shkëputja normale; 16. Shptyje; 17. Kurinj mbulesor të deformuar në etapën neotektonike; 18. Lartëshqitje mbihipse; 19. Fleksura e shkëputje sipas të dhënave gjeosfizike; 21. Mbihipje jo aktive; 22. Zona të ndrydhjes a dhe të tjerheqjes b; 23. Thyerje të thella sizmogjene; 24. Aksete brezave me nivele të ndryshme të tavani të gëllqerorëve (+ cektim, -thelli m).

fugishëm i cili në plan përvijon mirë zonën e Mirditës. Në skajin e saj VL anomalia Buge nuk mbyllt dhe vazhdon në zonën ofiolitike të Dinarideve s.s. Drejt pjesës JL të zonës së Mirditës anomalia është e ngushtë, me gjani më të vogël, ka pamjen e një mozaiku, me disa epikendra anomalistë vogla dhe mbetet e hapur drejt zonës Subpelagoniane të Helenideve. Kësish vërehet një ndryshim midis vazhdimit verior dhe atij jugor të zonës së Mirditës. Me sa duket, kjo gjë i detyrohet faktit që në pjesën veriore të kësaj zone masivet ofiolitike kanë përmasa të mëdha, deri në disa qindra km<sup>2</sup> (Bulqizë etj.). ndërsa në pjesën jugore të zonës të Mirditës, si dhe në Helenidet këta masivë janë më të vegjël.

Zona e Korabit karakterizohet nga një fushë e forcës së rëndesës, të qetë me intensitet të ulët, njëlloj me atë që vërehet në zonën Pelagoniane të Helenideve. Kjo gjë shpjegohet me faktin se në zonën e Korabit nuk ka ofiolite dhe depozitim paleozoik janë të sharrëzuara mbi një zonë buzine kontinentale, që kësishoj del si dritare tektonike. Argumenta të ndryshme gjeologjike përkrahin mendimin se kjo mund të jetë zona e Krujës.

Në zonën e Alpeve Shqiptare është shquar një minimum i thellë i anomalisë Buge, i cili vijon pa ndërprerje edhe në zonën e Karstit të Lartë të Dinarideve, gjë që tregon se edhe në thelli të këto dy zona janë vazhdimi i drejtpërdrejtë i njëra tjetres.

Duke filluar nga Gjiri i Lalzit e më në JL, drejt Lushnjës, si dhe nga Sulova në Leskovik, me fjalë të tjera në vise të zonës Jonike e asaj të Krujës, shtrihet një “hulli” e dallueshme mië e forcës së rëndesës. Duke qënë se kjo anomali e Bugesë nuk ndjek kufijtë palogeografikë e zonave në fjalë, është shkatëruar, pasi në këto zona janë veçuar si njësi paleogeografike - strukturore. Me sa duket kjo dukuri mund të lidhet me depërtimin e masave evaporitike. Duke shkuar drejt JP nga zona e Sazanit, intesiteti i fushës së rëndesës rritet dora-dorës, si rrjedhojë e pranisë së masës monolite të pllakës së Adriatikut.

Izoanomalitë e forcës së rëndesës në stere e në shelfin detar të Adriatikut kanë drejtin të përgjithshëm VP-JL dhe vazhdojnë pa ndërprerje në zonën e Paksosit e në atë Jonike e Helenideve, nga njëra anë, si dhe në zonën Dalmate të Dinarideve, uga ana tjeter. Kjo ecuri pëson dy shhangje në drejtim JP-VL: njëra në J të Vlorës dhe tjetra në drejtimin Lushnjë-Elbasan-Dibër. Sipas të dhënavës sismologjike kjo e fundit përputhet me thyerjen tërthore sismogjene të njohur, e cila vazhdon deri në Shkup e më në L. Ndërkëq edhe në pjesën VL të tablosë së anomalive Buge spikat qartë thyerja tërthore Shkodër-Pejë.

Tipare të ngjashme ka edhe tabloja e përhapjes së fushës magnetike. Në shpërndarjen e fushës anomale të rëndesës dhe asaj magnetike ndikojnë kufijtë e dendësisë dhe kufijtë magnetikë të thelli së mëdha, që nga tavani i bazamentit kristalin e deri në kufirin Moho, si dhe struktura më të cekta të Albanideve.

Të dhënat e gravimetrisë, magnetometrisë, sismologjisë, kërkimeve sismike, elektrometrisë flasin për një stil tektonik mbulesor të Albanideve, me sharrizhimin e zonave me L mbi ato me P. Vazhdimi i brezave anomale të fushës së forcës së rëndesës, asaj magnetike dhe asaj sismologjike, nga albanidet në Dinaridet dhe Helenidet përfalcon, me të dhëna gjeofizike, mendimin për stil tektonik të ngjashëm të tjerë këtij sektori i rëndësishëm të brezit orogenik alpin mesdhetar me veçoritë e veta në çdo sektor.

## THE POSITION OF ALBANIDES IN THE ALPINE - MEDITERRANEAN OROGENIC BELT BASED ON GEOPHYSICAL DATA

Albanides, or the assemblage of geological structures that make up the territory of Albania, are a key point of the Alpine - Mediterranean Orogenic Belt.

Albanides began their geological evolution in the Trias, upon a Hercynian substratum and were formed by the Alpine orogeny. The main orogenic stages were those of the late Jurassic-early Cretaceous (paleotectonic stage), the end of Cretaceous-Eocene (tectonic stage), the Oligocene-Miocene (traditectonic stage) and the Pliocene-Quaternary (neotectonic stage). The paleotectonic stage, that caused the emplacement of the ophiolitic suite, as shavings of the Thethysain oceanic crust, has affected only the inner zones of Albanides. They are thus separated from the external zones, which are components of the Adrias (Apulian plate) continental margin and are affected only by the latest tectonic, tarditectonic and neotectonic stages.

The structures of Albanides, with typical Alpine tectonic style, usually have a SSE-NNW direction. They are asymmetrical, with western tectonic vergence, sometimes recumbent or reversed and with numerous faults and thrusts in the western flanks, that further develop into overthrusts, tectonic napes and carriages of one zone over another. So the whole Inner Albanides are completely allochthonous. In the Albanides there can be seen longitudinal and transversal deep fractures, the most prominent of which is the Shkodër-Pejë transversal fracture, which separates the north Albanides (sequence of the Dinarides in Yugoslavia) from the south Albanides (sequence in the Hellenides in Greece).

Many phenomena of salt tectonics with diaper piercements and phenomena of the gravity tectonics, are also prominent geological features of the Albanides.

As part of Alpine Orogeny, the Albanides have relatively high seismicity.

Interpretation of structural features of Albanides has been based on geological data. During these last years geological arguments have been completed with geophysical data, especially gravimetric, magnetometric and seismological data, which particularly help in the recognition of the deep structure of Albanides.

The map of distribution of gravity field shows a highly anomalous belt, which delineates the Mirdita Zone. In its NE margin the Bouguer anomaly is still open and continues in the ophiolitic zone of Dinarides. Toward the SE party of Mirdita zone this anomaly is narrowed, with a smaller amplitude and "mosaic" figure. It has many centers of smaller anomalies and remains open towards the Subpelagonian zone of Hellenides. Thus a difference between the northern and southern prolongation of Mirdita zone is noticed. Evidently this phenomenon is due to the fact that in the northern part of this zone, the ophiolitic massifs have a considerable size of many hundreds km<sup>2</sup> (Bulqiza etc.), while in the southern part of Mirdita zone (and also in the Hellenides) these massives are smaller.

Korabi zone is characterized by a quiet gravity field, with low intensity, similar to that of Palagonian zone of Dinarides. This phenomenon is explained by the lack of the ophiolites in Korabi zone, where the Paleozoic deposits are charriaged over a continental margin zone, which seems as a tectonic window. Many geological arguments support the opinion that this tectonic window belongs to Kruja zone.

In the Albanian Alpine zone there a deep minimum of the Bouguer anomaly, has been identified which continues uninterruptedly in the High Karst zone of Dinarides. This reveals that these two zones are direct continuations of one another even in the deep parts.

A marked "trough" of gravity field extends from Lalezi Bay toward SE, in Lushnja, Sulova and Leskovik regions of Ionian and Kruja zones. This Bouguer anomaly does not reflect the paleo-geographical configuration of these zones and in this way it has been proved that this anomaly has been caused after the individualization of these zones as isopic units. It seems that these phenomena are related with the piercement of evaporite. In its SW extension, toward Sazani zone, the intensity of gravity fields gradually increases, as a result of the presence of Adriatic plate.

The isoanomaly of gravity field in the mainland and Adriatic continental shelf generally have an uninterrupted NW-SE strike also in the Paxos and Ionian zone of the Hellenides in one direction, and in the Dalmate zone of the Dinarides in the other. This trend is complicated by two deviation of SW-NE directions, one in the south of Vlora and the other in Vlora- Elbasan-Dibër direction. According to the seismological data the last deviation coincides with the known seismogene transversal fault which continues up to Skoplje and even further on the east. In the NE part of Bouguer anomaly map a Shkodër-Pejë transversal fault can easily be seen.

Similar features are characteristic also for the distribution of the magnetic field anomalies.

The density boundaries and the great depth magnetic boundaries, from the top of crystalline basement till Moho discontinuity, and also the other shallower structures of the Albanides, influence in the distribution of anomalous gravity and magnetic fields.

The gravity, magnetic, seismology, and seismic prospecting data indicate a nape tectonic style for the Albanides, with the carriage of eastern zones over the western's.

The prolongation of anomalous gravity, magnetic and seismological fields from Albaindes to Dinarides and Hellenides, reinforce the opinion for the existence of similar tectonic style of this important area of the Alpine-Mediterranean Orogenic Belt. On the other hand each of them have their own specific characteristics in any sector.

# NDERTIMI I HARTAVE KRAHINORE GRAVIMETRIKE DHE MAGNETOMETRIKE DHE INTERPRETIMI I TYRE NE STUDIMIN GJEOLOGJIK TE ALBANIDEVE

Salvator Bushati  
Alaudin Kodra  
Llambi Langora

Ndermarrja Gjeofizike, Tiranë  
Ministria e Industrisë, Minierave dhe Energetikës  
Ndermarrja Gjeofizike, Tiranë

Punimet gjeofizike të kryera vitet e fundit në gjithë territorin e Shqipërisë në shkallë 1:500.000 për studimin e shpërndarjes së forcës së rëndesës dhe të fushës gjeomagnetike, të bashkërenduára me të dhënat gjeologjike kanë sjellë një informacion të gjerë për strukturën e Albanideve.

Përhapja e fushës së forcës së rëndesës në Albanide, e parë në plan krahinor, lidhet edhe me ndryshimin e bazamentit kristalin.

Bazuar në lidhjet ndërmjet trashësisë së kores së tokës dhe anomalisë Bouge si edhe me të dhenat sismologjike është bërë vlerësimi i tabanit të poshtëm të kores së tokës. Këto rezultate përkonjnë me të dhënat e vendeve fqinjë për vazhdimësinë e tyre.

Në mënyrë më të përgjithësuar Albanidet ndahen në zona të brendshme dhe të jashtme, të cilat për nga veçoritë kryesore gjeologjike dhe karakteristikat e shperndarjes së fushave potenciale paraqiten si më poshtë:

**A. Albanidet e brendshme.** Në to bëjnë pjesë zonat e Korabit e të Gashit që ndertohen kryesisht nga shiste paleozoike dhe zona e Mirditës me përhapje të gjerë të ofioliteve jurasike.

Në zonat e Korabit dhe të Gashit fitohen fusha të qeta, gjë që mbështesin interpretimet sipas të cilave poshtë shisteve paleozoike etj. nuk shtrihen formacione ultramafike. Në të kundërtën, në zonën e Mirditës, në mënyrë mjaft të qartë, anomalitë Bouge jepin të dhëna për gjeometrinë e ofioliteve, me mbivendosjen dyanësore të tyre mbi buzët kontinentale lindore e kryesisht perëndimore. Masivet ultramafikë të Tropojë-Kukësit hartografohen nga një anomali gravimetrike që shënohet me intensitet më të lartë në të gjithë përhapjen e ofioliteve të Albanideve. Fushat anomale gravimetrike dhe magnetometrike argumetojnë zvogëlimin progresiv të trashësisë së ofioliteve të brezit lindor, nga veriu në jug, dhe zhvillimin në trashësi të kufizuar (2 - 7 herë) të ofioliteve të brezit perëndimore në krasim me atë lindor. Duke marrë në konsideratë të dhënat gjeofizike për ofiolitet perëndimore të Dinariteve (masivet Konjuk, Borje, Zllatibor, Zllator, etj.) del mirë në pah afersia e tyre me ofiolitet tonë të brezit perëndimore, gjë që mbështetet edhe me të dhëna të karakterit petrologjik e metalogenjik.

**B. Albanidet e jashtme.** Në to bëjnë pjesë zonat e Krastë-Cukalit-Alpeve, Krujës, Jonike dhe Sazani.

Të dhënat gravimetrike dhe magnetometrike për rajonin e Kostenjë-Okshtunit, të




Fig. 1

nënzonës së Krastës mohojnë mundësinë e pranisë së masave ofiolitike poshtë fllsheve kretak paleogenike e jurasiko-kretake, pra mbështetet interpretimi që masivet ultrabajkë të Bulqizës e të Shebenikut janë të veçura.

Anomalia e gjerë gravimetrike në rajonin e Kërçishtit dhe prania e gëlqerorëve neritike të Santianianit tepër të ngjashëm me ato të zonës së Krujës, si dhe dalja e tyre së bashku me evaporitet dhe fllshet paleogenike në trajtë dritare tektonike nën shkëmbinjtë mesozoikë të Krastës e paleozoike të Korabit, mbështet mirë interpretimet për praninë e zonave të jashtme në rajonet më lindore të Albanideve.

Zona e Alpeve shqiptare dallohet me një minimum të thellë të anomalisë Bouge, ndërsa në zonat Jonike dhe Sazani argumentohet një ngritje e dukshme, gjë që mbështetet edhe me të dhënrat sizmike.

Minimumi i anomalisë Bouge në sektorin nga Gjirokastra i Llesit, Lushnjë, Dumre lindore deri në Leskovik, evidentohet mjaft mirë dhe me sa duket flet për një ulje në perëndim të Krujës.

Në bazë të matjeve gravi-magnetometrike përfshohen të dhëna të reja në lidhje me elementet kryesore paleotektonike dhe tektonike si thyerjet transformuese Shkodër-Pejë, apo Vlorë-Dibër, etj.

## COMPILATION OF THE REGIONAL GRAVITY AND MAGNETIC MAPS AND THEIR INTERPRETATION TO THE GEOLOGICAL STUDY OF ALBANIDES

The gravity and magnetic geophysical investigations on the scale 1: 500.000 carried out recently throughout Albania for the study of gravity and magnetic field distribution, in concert with geological data, have brought a large information about the structure of Albanides.

From a regional point of view, the gravity field distribution in Albanides is related to the variation of crystalline basement as well. Based on the relation between Earth's crust thickness with Bouguer anomaly and on seismological data, the determination of this thickness has been carried out. These results agree with those of the neighboring countries in their sequence.

In a more generalized way, Albanides are divided into Inner and External zones, which in relation to the main geological features and the distribution characteristics of the potential fields are presented as follows:

**A. Inner Albanides.** Here are included the Korabi and Gashi zones, which are mainly constructed by Paleozoic schists and Mirdita zone, with a large extension of Jurassic ophiolites.

In the Korabi and Gashi zones quiet fields have been obtained, which support the interpretations according to which, no ultramafic formation is present under the Paleozoic schists etc.

On the contrary, in Mirdita zone, the Bouguer anomalies quite clearly bring forth data for the ophiolites geometry. Both ophiolitic belts are overthrust into continental margins, in the east and mainly in the west. The ultramafic massif of Tropoja-Kukësi is outlined by an

intense gravity anomaly which is the highest throughout the ophiolites of Albanides.

The gravity and magnetic anomalies support the progressive decrease of the ophiolite thickness in the east belt, from the north to the south as well as the limited thickness of the west belt unlike the east belt (2 to 7 times).

Taking into consideration the geophysical data of western Dynarides ophiolites (Konjuk, Borje, Zllatibor, Zllator massifs) which present limited thickness (the order 1-2 km), their similarity with our western belt ophiolites is clearly evident. This fact is supported with petrological and metallogenetic data as well.

**B. External Albanides.** Here are included the Krasta-Cukali, Alps, Kruja, Ionian and Sazani zones.

The gravity and magnetic data of Kostenje-Okshtun region in the Krasta subzone negate the possibility of the presence of ophiolites under the Cretaceous-Paleogenetic and Jurassic-Cretaceous flysch, so the interpretation that ultrabasic massifs of Bulqiza and Shebeniku are isolated to each other is backed up.

The wide gravity anomaly in the Kerçishti region, the presence of neritic limestones of Santonian, very similar with those of Kruja zone, their outcrop in conjunction with evaporite and Paleogenetic flysch in the pattern of tectonic windows under the Mesozoic rocks of Krasta and Paleozoic zones of Korabi, strongly support the interpretations about the presence of External zones in the most eastern regions of Albanides.

The Albanian Alps zone is characterized by a deep minimum of the Bouguer anomaly, while in the Ionian and Sazani zones a distinct uplift of the basement bears in evidence through the positive gravity anomaly. Such an interpretation agrees with seismic data.

The minimum of Bouguer anomaly in the sector Gjirokastër-Lalzit, Lushnjë, east Dumre up to Leskovik is clearly seen and seems to be related with a depression in the western of Kruja.

Thanks to gravity and magnetic measurements, new data in relation to the main paleotectonic and tectonic elements, like Shkodër-Pejë, Vlorë-Dibër transform faults etc., are obtained.

# VLERESIMI I RREZIKUT SIZMIK NE SHQIPERI (NE NIVEL NACIONAL)

Eduard Sulstarova

Qendra Sizmologjike, Tiranë

Shqipëria është një vend me veprimtari të lartë sizmike, është nga vendet më aktive në rajonin e Mesdheut. Vetëm gjatë 40-vjetëve të fundit Shqipëria është goditur nga 8 tërmete shkatërrues me  $M > 6,0$  të cilët kanë shkatuar viktima dhe dërme të konsiderueshme materiale. Gjatë kësaj periudhe tërmeti më i fortë ka qenë tërmeti i 15 prillit 1979 me  $M = 7,2$  ( $I_o > IX$  ballë MSK-1964), me epicendër në detin Adriatik, në afersi të kufirit Mali i Zi-Shqipëri.

Studimet për vlerësimin e rrezikut sizmik në nivel nacional dhe lokal janë kryer dhe po kryen nga Qendra Sizmologjike e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Në vitin 1979 përfunduan studimet për rajonizimin sizmik të Shqipërisë në shkallën 1: 500.000, ndërsa tani po punohet për rajonizimin sizmik në shkallën 1: 200.000.

Në këtë artikull, mbështetur në të dhënat sizmologjike dhe sizmotektonike, jepen rezultatet kryesore dhe metodologjitet që janë përdorur e po përdoren për vlerësimin e rrezikut sizmik në Shqipëri.

## SEISMIC HAZARD ASSESSMENT IN ALBANIA AT NATIONAL LEVEL

Albania is a country of a high seismic activity, one of the most active in the Mediterranean region. Only during the last forty years our country was hit by 8 destructive earthquakes of  $M > 6,0$  which caused human losses and considerable damages. The strongest ones is the earthquakes of April 15. 1979 (  $M = 7,2$  ;  $I_o > IX$ MSK-1964); its epicenter was situated between Albania and Montenegro, in Adriatic Sea.

The investigation for seismic hazard assessment at national and local level, have been performed and are under process from the Seismological Center of Academy of Albania. The studies for the seismic zonation of Albania on scale 1: 500.000, have been accomplished in 1979, and at present we are working for the seismic zonation of Albania on scale 1: 200.000.

Some results and methodologies used for seismic hazard assessment in albania are presented in this paper.

# STUDIME PALEOMAGNETIKE NE SHQIPERI

Hermann J. Mauritsch  
Përparim Alikaj  
Vangjel Melo

Institut fur Geophysik, Leoben, Austria  
Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave  
Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave

Në përputhje me marrëveshjen dypalëshe të bashkëpunimit midis Shqipërisë dhe Austrisë, përkatësisht Universitetit Politeknik të Tiranës, Universitetit të Leobenit dhe Ndërmarrjes Gjeofizike të Tiranës, u ndërmor ky studim paleomagnetik. Marrja e kampioneve filloj pranë Korçës në sedimentet e oligocenit dhe kretakut të sipërm si dhe ato të titonianit të Albanideve të Brendshme. Marrja e kampioneve vazhdoi në drejtimin Pogradec-Elbasan deri në Tiranë, duke ndërpërrezonat e Krastë-Cukalit dhe Krujës. U shpua përsëri në moshat e oligocenit dhe miocenit të mesëm. Në rrëthinan e Tiranës u muarën kampionet e oligocenit pranë Petrelës dhe kretakut të sipërm si dhe eocenit në malin e Dajtit. Më tej në veri, u morën kampione në një antiklinal gëlqerorësh të kretakut të sipërm (mastiqtian) pranë Rubikut dhe në gëlqerorët e neokomanit të zonës Dinarike (Alpet e Shkodrës).

